



BULETIN INFORMATIV

Janar - Qershor 2009

KOMISIONI PËR BUXHET DHE FINANCA



Kuvendi i Republikës
së Kosovës



Janar - Qershor 2009





PËRMBAJTJA

FUSHËVEPRIMTARIA E KOMISIONIT

PLANI I PUNËS 2009

MBLEDHJET E KOMISIONIT

SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJEVE

DËGJIMET PUBLIKE

MBIKËQYRJA ZBATIMIT TË LIGJEVE

RAPORTIMI I MINISTRAVE DHE
PËRFAQËSUESVE TJERË

VIZITA E NËN - KOMITETIT PËR
ADMINISTRATË DHE SIGURI TË
PARLAMENTIT FINLANDEZ

STATISTIKA

PËRBËRJA E KOMISIONIT

Fushëveprimtaria e Komisionit

Komisioni për Buxhet dhe Financa është njëri nga komisionet kryesore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili ka të përcaktuara fushat e veprimtarisë së tij. Në kuadër të fushëveprimit të tij, Komisioni shqyrton: çështjet buxhetore dhe financiare, Buxhetin vjetor të Republikës së Kosovës, shpenzimet e mundshme që mund t'i bartë një projektligj dhe bënë rekomandime në komisionin përkatës funksional të Kuvendit, raportet periodike dhe vjetore të organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike, kërkesat financiare të organizatave buxhetore, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga Qeveria dhe institucionet tjera, si dhe çështje të tjera buxhetore dhe financiare.



Plani i Punës 2009

Në muajin shkurt, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka miratuar Planin e Punës për vitin 2009, në bazë të të cilit ka zhvilluar aktivitetet si komision kryesor. Plani i Punës është hartuar në përputhje me Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2009 dhe objektivat e Komisionit.

Për vitin 2009, në Planin e Punës, Komisioni kishte paraparë: shqyrtimin e të gjitha projektligjeve për të cilat Komisioni është funksional, shqyrtimin e



raporteve me amendamente nga komisionet funksionale, shqyrtimin e raporteve vjetore të organizatave buxhetore, realizimin e vizitave brenda dhe jashtë vendit, monitorimin e zbatimit të ligjeve të përzgjedhura nga Komisioni, organizimin e dëgjimeve publike për ligje të caktuara, raportimin e

Ministrave përkatës dhe përfaqësuesve tjerë para Komisionit për çështjet që Komisioni i vlerëson të rëndësishme, bashkëpunim me të gjitha organizatat relevante vendore e ndërkombëtare dhe shqyrtimin e Projektbuxhetit të Kosovës për vitin 2010.

Në përgjithësi, duke marrë parasysh aktivitetet e zhvilluara në gjashtëmujorin e parë, Komisioni ka arritur në masë të madhe të përmbush planin e punës. Përgjatë bërjes së projektligjeve të vonuara nga Qeveria, të parapara në Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2009.

Mbledhjet e Komisionit

Në gjashtëmujorin e parë, Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka mbajtur *17 mbledhje të rregullta*. Në këto mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar të gjitha raportet me amendamente nga komisionet funksionale dhe projektligjet për të cilat është caktuar si komision funksional. Gjithashtu, Komisioni ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe raportet vjetore financiare të organizatave buxhetore si dhe ka shqyrtuar propozim - vendimet e Qeverisë.

Për të qenë sa më efektiv në punën e tij, Komisioni në gjashtëmujorin e parë, ka formuar *4 grupe punuese*, nga një grup për secilën projektligj, të cilat kanë mbajtur 9 takime.



Me ftesë të Komisionit, në takime kanë prezantuar përfaqësues të ministrive (ministra, zëvendësministra, etj.) dhe përfaqësues të organizatave tjera buxhetore. Mbledhjet e Komisionit kanë qenë publike dhe janë monitoruar nga përfaqësues të organizatave qeveritare dhe jo qeveritare vendore e ndërkombëtare. Në mbledhjet e Komisionit janë zhvilluar debate të hapura dhe konstruktive.

Shqyrtimi i Projektligjeve

Në gjashtëmujorin e parë, Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar 14 projektligje me raporte si komision kryesor dhe 5 *projektligje*, për të cilat ka qenë komision funksional. Projektligjet e shqyrtuara nga Komisioni, për të cilat ka qenë komision funksional janë:



- Projektligji për Raportimet Financiare të Organizatave të Biznesit;
- Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH);
- Projektligji për Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar dhe Ndërkombëtar dhe Organizatat e Grupit të Bankës Botërore;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Auditimin e Brendshëm
- Projektligji për Tatimin në të Ardhura të Korporatave

Në këtë gjashtëmujor, Komisioni, ka shqyrtuar edhe shumë çështje tjera, si: Raportin Vjetor të Punës për vitin 2008, 19 raporte financiare të organizatave buxhetore duke përfshirë edhe Raportin e Shpenzimeve të Buxhetit të Kosovës për vitin 2008, 8 kërkesa të organizatave të ndryshme buxhetore, 6 propozim vendime të Qeverisë së Kosovës dhe ka bërë disa rekomandime si komision me kompetencë.

Dëgjimet Publike

Qëllimi i organizimit të dëgjimeve publike nga komisionet është grumbullimi i sa më shumë informatave dhe përfaqësimit sa më të madh, duke përfshirë edhe grupet e interesit. Është me interes që në këto takime të përfshihen sa më shumë përfaqësues të grupeve që preken drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë nga ligji apo çështja për të cilën mbahet një dëgjim publik.



Në gjashtëmuajorin e parë, Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka mbajtur *një dëgjim publik*. Dëgjimi është mbajtur për **Projektligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar - TVSH**. Në këtë dëgjim morën pjesë rreth 30 përfaqësues që përfaqësonin Qeverinë, odat ekonomike vendore dhe të huaja, organizatat e biznesit, organizatat joqeveritare dhe mediat. Komisioni gjatë amendamentimit të projektligjit mori parasysh rekomandimet e dala nga dëgjimi publik.



Mbikëqyrja e Zbatimit të Ligjeve

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, neni 53, Komisioni ka autoritetin të mbikëqyr zbatimin e ligjeve nga Qeveria e Kosovës ose ministria përkatëse. Mbikëqyrja e ligjeve nga Komisioni bëhet me qëllim të vlerësimit të zbatimit të

ligjeve dhe ndërmarrjes së masave për përmirësimin e gjendjes aktuale duke propozuar rekomandime konkrete për institucionet përgjegjëse.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bazë të autoritetit që ka, në muajin maj ka përzgjedhur të mbikëqyr zbatimin e **Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal**. Për këtë qëllim, Komisioni, formoi një grup punues, i cili do të hartoj një raport mbi nivelin e zbatimit të ligjit. Në muajt e ardhshëm, grupi punues do të zhvilloj aktivitetet në bazë e tij dhe do të dalë me një raport mbi gjendjen aktuale të zbatimit të ligjit në fjalë.



Raportimi i Ministrave dhe përfaqësuesve tjerë

Në gjashtëmujorin e parë, me kërkesë të Komisionit, kanë raportuar Ministri dhe Zëvendësministri i Ekonomisë dhe Financave, z. Ahmet Shala dhe z. Bedri Hamza. Gjatë shqyrtimit të raporteve dhe kërkesave të ndryshme, në mbledhjet e Komisionit, kanë prezantuar përfaqësues të organizatave buxhetore raportuese.

Vizita e Nën - komitetit për Administratë dhe Siguri të Parlamentit Finlandez

Në muajin maj, Komisioni për Buxhet dhe Financa, në një takim priti një delegacion nga Parlamenti Evropian. Delegacioni përbëhej nga anëtarët e Nën komitetit për Administratë dhe Siguri të Parlamentit Finlandez. Qëllimi i vizitës së këtij delegacioni ishte njohja me punën e Komisionit për Buxhet dhe Financa, funksionimi dhe menaxhimi i buxhetit të shtetit dhe vënia e bashkëpunimit reciprok mes dy komisioneve.

Statistika

- Mbledhje të komisionit	17
- Projektligje të shqyrtuara	19
- Grupe punuese	4
- Takime të grupeve punuese	9
- Vizita	0
- Monitorimi i ligjeve	1
- Dëgjime publike	1


Përbërja e Komisionit



Gani Koci (PDK)
Kryetar i Komisionit



Naser Osmani (LDK)
Zëvendëskryetar i Parë



Kosara Nikolic (SLS)
Zëvendëskryetare e Dytë




Safete Hadergjonaj (PDK)
Anëtare



Hajdin Abazi (PDK)
Anëtar



Haki Shatri (AAK)
Anëtar



Myrvete Pantina (LDK)
Anëtare



Shkumbin Demalijaj
AKR - Anëtar



Armend Zemaj (LDK)
Anëtar



Besa Gaxherri (LDD)
Anëtare



Mufera Sinik (7+)
Anëtare



Riza Smaka (AKR)
Anëtar



Kontaktet

Marrëdhëniet me Publikun

Sherif Konjufca Shef i Seksionit

Zyra N - 08, Kati përdhes

038 211 186
sherif.konjufca@assembly-kosova.org

Stafi mbështetës i Komisionit

Natasha Prica Administratore e Zyrës

Zyra N - 322 , Kati III

038 211 295
natasha.prica@assembly-kosova.org

Vilson Ukaj Zyrtar Ligjor

038 213 800
vilson.ukaj@assembly-kosova.org

Dashurie Canolli Asistente Teknike

038 211 853
dashurie.canolli@assembly-kosova.org

Zyrtarët nga NDI që e mbështesin Komisionin

Shefki Kastrati Zyrtar Legjislativ

Zyra N - 409, Kati IV

038 212 532 shefkikastrati@gmail.com
044 513 651

Teki Shala Ekspert

044 188 424 tekishala@yahoo.com

Webfaqja e Kuvendit

www.kuvendikosoves.org

Përkrahur nga:

